



Data: 11/09/2020 Ref.: 1566/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
 - Menaxhment dhe Ndërmarrësi, BSc, 180 ECTS, me specializim në: 1. Menaxhim dhe Ndërmarrësi, 2. Menaxhimi i Marketingut dhe Shitjes , maksimum 100 student për vit akademik
- II. Akreditohet programi i studimit të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” për periudhën pesë vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2025:
 - Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS, maksimum 180 student për vit akademik
- III. Obligohet Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” që deri me datë 31 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Gjilanit, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitivin I, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se këto programe i përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë